

Kush është INOBAT?

“Organizata e interesit për përpunimin e baterive” bashkon plot 130 firma anëtare nga prodhimi, importi dhe të rretheve të tregtisë. Me autorizimin e Entitit Federal për Ambient, „BAFU”, INOBAT bën vjeljen e taksave për përpunimin e baterive (VEG), të cilën e paguajnë konsumatorët në çmimin e blerjes së baterive dhe akumulatorëve. Me këtë INOBAT financon grumbullimin, transportin dhe riciklimin e baterive të shpenzuara nëpër amvisëritë dhe ndërmerr masa për informimin dhe reklamimin për treg dhe popullatë.



Në televizion dhe pllakate: reklamë me humor të plotë për grumbullimin e baterive.

Meqë ra fjala: edhe lodrat që aktivizohen me bateri duhet përpunuar në mënyrë profesionale. Ju lusim, që pas përdorimit ti ktheni në vendin e blerjes.
www.sens.ch



Të gjitha të tjerat nën www.inobat.ch

Në faqen e internetit INOBAT do të gjeni informata, udhëzime, faqe ndërlidhëse si dhe një film informativ rreth angazhimit për përpunimin korrekt të baterive & akumulatorëve.

INOBAT, Postfach 1023, 3000 Bern 14
inobat@awo.ch



Bateritë duhet ripërpunuar drejtë.



Bateritë & akumulatorët pas përdorimit duhet të kthehen prapa



Bateritë & akumulatorët duhet të kthehen prapa

Bateritë & akumulatorët nuk kanë se çka të kërkojnë në hedhurina të zakonshme. Ligji na obligon çdo njërin nga ne, që bateritë pas përdorimit ti



kthejmë prapë në vendin e shitjes ose në një vendgrumbullim tjetër. Përse? Riciklimi korrekt mundëson në një rën anë ndarjen e helmeve të metaleve të rënda, si kadmium, plumb dhe zhivë nga hedhurinat tjera. Në anën tjetër përmes kësaj përfitojmë lëndë të rëndësishme bazë.

Një e treta zhduket në hedhurina të zakonshme

Bateritë & akumulatorët janë pjesë e përditshmërisë sonë. Në forma, madhësi dhe përbërje të ndryshme na sjellin energji të akumuluar. Ne i blejmë ato të paketuara, p.sh si bateritë për përdorim në amvisëri në formë të një



shkopi ose të integruara në aparate të amvisërisë, p.sh në formë të një pulle në një orë ose si akumulator në telefonat celular, në Laptop ose kamera digjitale. Në Zvicër, çdo vit përmes shitoreve shiten 3'700 tonë

bateri dhe akumulator. Plotë dy të tretat kthehen dhe hyjnë në rrethin për riciklim. Një e treta përfundon në hedhurinat e amvisërisë. Fatkeqësisht!



Në çmimin e blerjes është përfshirë edhe kthimi

Ai që blen bateri & akumulator, në mënyrë automatike fiton të drejtën për kthimin dhe përpunimi e tyre profesional. Paraprakisht në çmimin e blerjes është zbatuar pagesa për kthim, e ashtuquajtura (Vorgezogene Entsorgungsgebühr VEG).

Kthimi është i thjesht dhe pa pagesë

Shitorja është e obliguar ti pranoj, bateritë dhe akumulatorët e përdorur. Pra ju mund ti ktheni aty ku i keni blerë. Në Zvicër ka mbi 12'000, vende të cilat merren me grumbullimin e tyre: shitore, qendra tregtare, shitore profesionale për foto, elektronik dhe Telefona Celular, në post, kiosqe si dhe në pompa të benzinës. Këtyre i bashkëngjiten edhe shumë vende grumbulluese të ofruara nga komunat.



Etiketa për kthim, Battery Bag, Battery Box: çdo gjë për përpunimin e të gjitha baterive pa vështirësi.

Një jetë të dytë për resurset e fituara

Bateritë dhe akumulatorët e shfrytëzuar arrijnë në punëtorinë e riciklimit



Batrec AG në Wimmis (www.batrec.ch).

Atje bëhet ndarja mekanike dhe kimike përmes një procesi në shumë faza.

Metalet e përfituara si zinku dhe para së gjithash mangani i metaltë, i shiten Industrisë si lëndë e parë, për përdorim të dytë.

